



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I.Numër: 060/01-93228

Pejë, datë: 29 Nëntor 2024

PROCESVERBAL

Nga takimi i -X- të i rregulltë i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me: **29 nëntor 2024**, me fillim në orën 10:00 h.

Takimi u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Në takim prezantojnë: pos anëtarëve të kuvendit të komunës, kryetari i komunës z. Gazmend Muhaxheri, nënkryetari z. Fatmir Asllani; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj; drejtorët e SHCK-së, z. Avni Gashi, udhëheqës i sektorit të kuvendit, zyrtare administrative znj. Donjeta Morina; përfaqësues të ZIP-it, përfaqësuesit të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Në vazhdim takimin e kryesoi; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hapi diskutimin për rendin e ditës dhe i sqaroi pikat të cilat janë vendosur në rend dite, pastaj konstatoj se janë 32 anëtarë prezent.

Nga të gjithë anëtarët prezent, me 30 vota pro (dy votë me ngritje dore), 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, u miratua ky rend dite me propozimin që u dha nga kryesuesi:

REND DITE

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.
2. Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.
- 2.1 Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës së Pejës nga subjekti politikë LDK, z. Bekim Morina.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të K.K. Pejë, dt. 29.10.2024.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje.
5. Shqyrtimi dhe miratimi pas diskutimit publik i Draft Plani të Punës së Kuvendit të Komunës së Pejës

2025.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Kalendarit të takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2025.

7. Shqyrtimi dhe miratimi pas diskutimit publik i Draft - Planit Lokal të Veprimit Për Barazinë Gjinore, 2024 – 2027.

8. Shqyrtimi i informatës për ndarjen e bursave për student.

9. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:

10. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.

Në takim munguan z. Rustem Berisha, z. Granit Kelmendi, dhe z. Rajan Arapi.

2. Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.

Nuk ka pasur.

2.1. Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës së Pejës nga subjekti politik LDK, z. Bekim Morina.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, e ftoj anëtarin e ri të Kuvendit të Komunës z. Bekim Morina nga subjekti politik LDK që ta jap betimin, pas vendimit të KQZ-së mbi emrimin e tij, duke zvendësuar anëtarin poashtu nga i njëjti subjekt. Pas betimit anëtari i ri është anëtar i kuvendit me drejta të plota.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të K.K. Pejë, dt. 29.10.2024.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 28 votë pro (2 votë me ngritje dore), 4 votë të përmbajtur u miratua procesverbali i K.K. Pejë, dt. 29.10.2024.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: nga drejtoria e financave është kërkesë për ndryshimin e mjeteve për shkak në lidhje me gjygjësorin që mka ardh dhe ka ndiku tek kategorit e ndryshme.

Z. Egzon Kastrati: duke e ditur që komuna e Pejës është duke u përballur me një pa rregullësi të madhe, si pasojë e ekzekutimit të vendimeve gjygjësore që po vin nga kontrata kolektive. Ne jemi të detyruar që sot ta bijmë këtë pikë, duke u bazuar në ligjin për ndarje buxhetore neni 15, paragrafi 7 ku thotë përjashtimishtë paragrafi 2,3 dhe 5, nuk lejohet asnjë transfer i mjeteve buxhetore në kategorinë e pagave dhe shtesave pa miratimin e kuvendit. Përjashtimishtë ky transfer do të bëhet sipas nenit 10 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe

përgjithësive, në tre mujorin e fundit në kategorinë e pagave dhe shtesava. Athere kur kjo kategori është atakuar nga ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë. Duke u bazuar në këto dispozitiva ligjore, ne kerkojmë nga ju që sot të bëhet vetem korigjimi i shpenzimit të kategorit ekonomike nga keto kategori në kategorinë e pagave ashtu siq e parasheh edhe ligji në tremujorin e fundit. Në mënyrë që ti ikim keqklasifikimit të shpenzimeve sepse kjo ndikon drejtë për se drejti edhe në raportin e auditimit, vlera është 1,303,113.13 euro e cila është mar nga kategorit mallra dhe shërbime dhe subvencine nga tri fondet burimore dhe kjo është shumë e rëndësishme të bëhet në menyre që komuna e Pejës ti ik keqklasifikimit. Ndërsa e jona këtu është të kaloj në kuvend, pastaj shkon në ministri dhe shiqojmë se a do të bëhet ky korigjim i shpenzimeve nëpër kategori siq e parasheh edhe legjislacioni në fuqi.

Z.Naim Bytyqi: pyetja ime ka të bëj vitin e kaluar se a është pa ligji që duhet mrenda 3 muajve të fundit të regullohen keto kategori buxhetore të cilat gjatë tri viteve të fundit po bëhen bartje dhe transfere. A është bërë vitin e kaluar e njëjta gjë?

Znj.Eleonora Bala: mua vetem po më intereson se a kanë mujt keto vendime gjyqësore të evitohen nga ana e juaj sepse kur diskutojshim për pagat jubilarë e tash kohën e fundit dhe për pagën e 13 thojshit që nuk është kompetencë e komunes! Prandaj mendoj që pa nevoj janë bërë do pagesa, që kanë mujt me kohë të evitohen.

Z.Islam Husaj : unë, e mbështes këtë propozim pastaj ministria e ka fjalën e fundit ajo vendos të aprovoj apo jo! Por e jona është se pa vendimin tonë, as ministria nuk mundet me vendos.

Z.Egzon Kastrati: Te pyetja e Naimit, jo vitin e kaluar nuk e kemi bërë, mirëpo këtë vit po e bëjmë sipas legjislacionit, siq tha edhe z.Islami është në diskretëcionin e ministrisë për me rregullu. Ndërsa sa i përket kontratave kolektive nuk është pyet asnjë kryetar i komunës po ashtu edhe me diskutime që i kemi pas me auditoret e jashtëm, problemi kryesor është që keto komuna kanë marr obligimet e dikujt tjetër pa qenë të obliguar dhe pa nënshkru vet. Se a ka mujt me u evitu nuk është problemi vetëm i komunës së Pejës por gjitha komuave. Dhe padrejtësishtë keqklasifikimi që po vjen si pasoj e kontratës kolektive, komunat relaisht po i largon nga përfitimi i Grandit të Përformancës sepse është kriter bazë!

Z.Naim Bytyqi: relaishtë ne nuk na intereson për komunat e tjera sepse ne jemi asambleistë të Komunës së Pejës. Athere qysh mundem me mbulu na kur gjatë dy viteve intezivishtë kam kërku që mos të ndodhin këto keqklasifikime ku janë mundu mem kërcënu pikërishtë për këtë fjalë, qysh u bo sot se si ministria po kerkon! Nese ministria nuk kish kërku a kishim vazhdu njëjt me kode ekonomike prej një kodi në kodin tjetër?

Z.Drin Veselaj: kjo që sot na sqaroi Egzoni ish dasht me ndodh shumë ma heret, nga zyrtaret tjerë që kanë qenë të financave dhe kjo nuk ka ndodhë! Pse athere na duhet me ardh mbas 3 viteve siq tha Naimi, me i mublu këto keqklasifikime dhe kjo është vërtet me u qudit ose nuk dini me kry punen ose e bë me qëllim. Pyetja ime ose kërkesë e imja është që na me kry mirë

punë ashtu siq e parashih ligji, e jo mbas 3 ose 5 vjetve mi kerku keto ne ketë formë, këto dështime që kanë mujt mos me ndodhë!

Kryetari Gazmend Muhaxheri: çfarë dështimi more është; duke i mar paret përmbarusi asnjë përgjegjësi se ka komuna e Pejës. Në krejt këtë proces jemi e vetmja komunë që i kemi shpëtuar 2.5 milionë dame të shkaktuara prej një ministri ose kryeministri, që ka bërë marrveshje pa bazë! Për këtë arsye ne po e bëjmë këtë sepse nuk janë në pyetje 3 vite por vetëm 1 vjet, dhe nuk ju kishim sjellë as këtë vit por po dojmë me mbetë në garë për mos me pas ministria arsyetim me na eliminu prej Granitit të Përformancës.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 19 votë pro, 12 votë kundër (dy votë me ngritje dore), 1 votë e përmbajtur, miratohet kërkesa për transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje.

5.Shqyrtimi dhe miratimi pas diskutimit publik i Draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Pejës – 2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është draft plani i punës së kuvendit obligohemi që para çdo fillim viti që ta prezentojmë planin e punës. Kemi formu komisionin dhe pastej kemi diskutu me gjithë anëtarët e kuvendit pastaj në takim me komisionin, në diskutim publik dhe pastaj në Draft Planin final!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 31 votë pro (2 votë me ngritje dore), 1 anëtar nuk ka marr pjesë në votim, miratohet Planin i Punës së Kuvendit të Komunës së Pejës – 2025.

6.Shqyrtimi dhe miratimi i Kalendarit të takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: sipas rregullit është e paraparë që seanca të mbahet në fillim të muajit, dhe materialet të jenë 7 ditë para seancës të dërguar tek anëtarët e kuvendit dhe pastaj seanca datat që janë në fund të muajit .

Nga të gjithë anëtarët prezent me 30 votë pro (2 votë me ngritje dore) 2 anëtar nuk ka marr pjesë në votim, miratohet Kalendari i takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2025

7.Shqyrtimi dhe miratimi pas diskutimit publik i Draft - Planit Lokal të Veprimit Për Barazinë Gjinore, 2024 – 2027.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: zyrtaren për Barazi Gjinore e kemi prezent nese ka ndonjë pyetje e hapim diskutimin.

Z.Drin Veselaj: ne si grup gjithmonë duke respektu barazinë gjinore edhe në këtë rast jemi pro këtij plani, gjithashtu duke i falenderu edhe anëtarët e grupit tonë për një kontribut të jashtëzakonshëm znj.Hida,dr.Ziza dhe znj.Vjendita, andaj ne si grup e përkrahim këtë plan.

Z.Berat Ganiqi: edhe ne si VV e përkrahim këtë Draft, po ashtu po bëj thirrje që barazia gjinore me u respektu gjithkund qoftë prej qeverisë së lartë, qoftë qeverisë lokale poshtë. Por ajo që po më vjen keq është se të pakten drejtoreshat është dasht me qendru ktu, me prit këtë pikë kur diskutohet dhe votohet pika më e rëndësishme.

Znj.Dafina Draga: zyrtarja për Barazi Gjinore nuk është vetem dhe si GGA e falenderojmë për bashkpunimin, përfshirjen dhe për gjithqka jemi bashkë!

Znj.Hidajete Krasniqi: po ashtu edhe unë duhet me përkrah Beratin pamvarsishtë që jemi bashkë krejt dhe kemi punu bashkë është një respekt sespe po dorzohet një Draft që është punu shumë, së paku kur e kenë ditë është dasht me u ndru rendi i dites që të jen prezent si përkrahje morale asgjë tjetër!

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: edhe unë po dua me falenderu GGA-në dhe zyrtaren e Barazis Gjinore që kanë qenë aktive në detyrat që i kanë marr dhe kanë punu shumë. Kanë marr pjesë në takime ,në puntori kanë dal në vizita në teren e kanë dhënë maximumin në këtë drejtim.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent miratohet **Draft** - Plani Lokal të Veprimit Për Barazinë Gjinore, 2024 – 2027.

8.Shqyrtimi i informatës për ndarjen e bursave për student.

Z.Drin Veselaj: të nderuar koleg dhe student, fatkeqësishtë po e shqyrtojmë një informat ku ish dasht me qenë prezent zyrtar që janë përgjegjës për këtë informatë, drejtori i arsimit ose kryetari. Mirëpo fatkeqësishtë nuk janë asnjëri! Ne vazhdimishtë e kemi potencu si një çështje shumë problematike, që gjatë ketyre viteve të qeverisjes së LDK-së për 10 vite ka ndodhë që ndoshta një here të shpërndahen bursat tek studentet. Pra kjo është një çështje shumë e rëndësishme për neve, miërpo edhe për gjithë studentet e Komunës së Pejës. Ne si student jemi shqu si student të mirë të Republikës mirëpo asnjehere nuk i kemi përkrah! Mandej kur vjen koha dalim vajtojmë se si studentet po na ikin , si studentët nuk marrin drejtime që janë të rëndësishme për komunën tonë.Nese e shohim ndarjen e bursave, fjala është për 10 bursa të cilat janë në vlerë 10 mijë euro që do të thotë 1 mijë euro për një bursistë. Po ashtu janë vetëm për dy degë matematikë dhe fizikë. Pra ndarja e ketyre 10 bursave nuk është asgjë më shumë se një darkë e ekzekutivit, që e bëjnë për çështje të ndryshme.Ne anen tjetër ne si komunë kemi jashtëzakonishtë probleme të theksuara me lëndët si me matematikë,fizikë dhe me shumë dega të tjera. Andaj keto 10 bursa që kanë ndodhë sot është e mirë për studentet, mirëpo është e pamjaftushme dhe kisha kërku edhe nga kryetari dhe nga drejtori i arsimit që në këtë pjesë të

fokusohen më shumë, t'i motivojnë studentet që me shku në drejtimet që na si komunë kemi nevoj!

Z.Feriz Gashi: deshta ta mbështes edhe une Drinin, 10 bursistë janë pak, sa e dim ne kanë aplikuar 14 veta për 10 bursa. Meqenëse nuk e kemi as kryetarin dhe as drejtorin e arsimit, mundemi me pyet zyrtarin e financave, a ka pas mundësi që edhe këtyre 4 studentëve se nuk kanë qenë shumë me j'u nda bursa? Dhe a ka mundësi me u zgjerru dhënja e bursave për studentet të fakultetit teknik? Kisha kërku që nese kish pas mundësi që edhe atyre 4 studentëve me ju shpërnda bursa se nuk janë shumë!

Z.Egzon Kastrati: nuk ka pas mundësi sepse ata kanë apliku me kontabilitet dhe financa , për ata edhe janë refuzu, sepse thirrja ka qenë e qartë. Të gjithë ata që kanë apliku në drejtimet matematikë dhe fizikë që janë shumë të nevojshme për tregun e punes, sidomos për shkollat në Pejë janë përkrah, pjesa tjetër nuk është përkrah sepse nuk i kanë pas drejtimet adekuate.

Znj.Hidajete Nikçi: pikërishtë e ceku Egzoni atë se çka deshta me pyet, sepse ketu i kemi pa vetem emrat e 10 përsoneve që kanë marr bursa e nuk i kemi pa emrat e atyre 4 studentëve që nuk j'u ka nda bursa. Ne gjatë gjithë kohes kemi kërku që qyteti i Pejës ose komuna të ketë një rregullore për ndarjen e bursave, e dim që komuna nuk ka rregullore të tillë. Nuk jemi kundër me u përkrah këto drejtime, mirëpo ne kërkojmë të zgjerohet dhe ta kemi një rregullore ku kanë të drejtë të aplikojnë edhe profilet e ndryshme edhe ata të fitojnë bursa. Unë, mendoj që aryeja që kanë apliku edhe këta me kontabilitet dhe financa është se në shkollë tona j'u ka kriju mundësia pikërishtë këtyre me dhënë këto lënd. Ndoshta edhe fakultetet tjera që kanë qenë më të përaferta, sidomos fakultetet teknike, dhe në qytetin tonë është bërë shprehi që orët mësimore të j;u ndahen më shumë ekonomistave, për ata mendoj që është kjo arsyeja që janë motivu për ketë çështje duke e pa se kush po jep matematike në shkolla tona.

Z.Nezir Jahmurataj: edhe unë ju kisha bashkangjitë kërkesës që komuna e Pejës të rrit buxhetin për shpërndarjen e bursave dhe të rrit drejtimet adekuate sidomos në drejtime të shëndetësisë. Dhe një kërkesë buxheti i Pejës për studenta me rrit në 100 mijë euro dhe me rrit shumen e bursave në 2 mijë euro.

Z.Islam Husaj:në kërkesë që une pata e filloj znj.Hidajete, por për ju kryesus dhe për drejtorin e arsimit kërkoj që nga janari të formohet një grup punues që të filloj me hartu rregulloren për ndarjen e bursave. Aty përcaktohen edhe kriteret dhe përcaktohen edhe kushtet që duhet të i plotësoj secili që konkuron për bursë. Sepse nuk mund të ndahen bursat pa rregullore, kjo që është bërë është bërë pa rregullore dhe nuk është në rregull! Por megjithëatë është mirë që janë nda, pak jonë dhe unë mendoj se në rregullore duhet të parashihen edhe drejtimet diversitare, edhe ata që nuk kanë mundësi shkollimi, por edhe përsoneat që kanë afinitete të posaqme e që munden me përparu shumë ma shumë me hulumtime dhe në shkencë. Të përkrahen edhe ata student që janë të veçant në studime. Në kërkesat e mija që i kam bërë kam kërku që me u hartu edhe dy rregullore të tjera, por deri tash nuk është bërë kurgjo! Kjo është e treta dhe kërkoj që në

fillim vit të formohen grupet punuese dhe të fillohet me plotësim/ndryshimin e ketyre rregulloreve që kam kërku dhe kësaj që të hartohet prej fillimit.

9.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: kemi kërkesë nga z.Naim Bytyqi, kërkesa erdhi me vonesë për me pas prezent drejtorin e KEDS për një informate. Mirëpo ka qenë shumë vonë dhe ka qenë e vështir me pregatit për me ardh për shkak që ka qenë kërkesë me vonesë. Duhet ta kemi parasysh që në seancë tjetër t'i dërgojmë kërkesë drejtorit të KEDS-it që të jet prezent në seancë, që të jep informata ose sqarime që atij i janë drejtuar!

Z.Naim Bytyqi: unë, po e diskutoj këtë çështje për heren e fundit sepse janë shfrytëzuar gjitha mundësit dhe rrugët ligjore. Dhe si anëtar i asamblesë komunale u mundova me shfrytëzu rrugen përmes asambles ta ftojme drejtorin e KEDS-it me informata, edhe kto ditë të fundit jam marr intezivisht ka pas edhe media të ndryshme, në fshatin Poqestë dhe në fshatrat për rreth për problemin e enegjrisë elektrike. Me të vërtet është teper dher ata banorë janë shumë keq me mungesë të energjisë elektrike. Unë, sot kam dasht me mar një informatë të sakt mbasi kryetari nuk është prezent, po unë kam dasht me pas një informatë se cilat janë kompetencat komuna mundet me i përdor, kryesisht kryetari i komunes për me j'u dal ndihmë atyre banoreve.

Z.Nezir Jamurataj: unë i bashkangjitna Naimit ktu që drejtori i KEDS-it, duhet me ardh për 12 muaj me raportu për gjendjen e furnizimit me energji elektrike.

10.Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit

Z.Labinot Panxha: deri sa u mbajt scanca ketu unë mora disa mesazha nga prinderit e nxënësve të shkollës "Vaso Pash Shkodrani". Prinderit e shqetësuar në mungesë të hapsirës së aktivitetet ku i zhvillojnë detyrat. Të cilat mësuesit i detyrojnë ata që të shkojnë në shkollën "Dardania", dhe nxënësit shkojnë pa përcjelljen e mësuesve, kjo është shumë shqetësuese për ata prind. Prandaj dhe e adresova si kërkesë, dhe kishte me qenë mirë me mar masa dhe shpresoj që po na dëgjon edhe drejtori i asaj shkolles "Vaso Pash Shkodrani" dhe poashtu edhe drejtori i arsimit z.Naser Gega. Në mënyrë që ti parandaloj keto levizje të nxënësve pa përcjelljen e mësuesve dhe te mos këtë ndonje fatkeqësi, si rezultat i mungeses së mospërgjegjësisë ndaj tyre nga mësuesi dhe drejtori i asaj shkolle.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është një çështje e ndishme sa i perket sigurisë së nxënësve, pasi që sësht drejtori prezent j'a përcjellim këto shqetësime!.

Z.Berat Ganiqi: është kërkesë e imja dhe e grupit tonë ,pasi që edhe po hyjmë në kohën e fushatave zgjedhore po kërkoj që në emer të I.VV.që gjatë procesit mësimor të fëmijve mos të ndërprehet orari i mësimit që të mbahen fushatat. Kjo dihet që ka ndodh në shkollën teknike " Rifat Gjota" është ndërpre 1 orë procesi mësimor për shkak se keni mbajt tubim publik. Unë


mendoj që secili subjekt politik të heq dorë nga këto tubime gjatë procesit mësimor sepse ata fëmijë po mbesin në rrugë dhe nuk po shkojnë në shtëpi. Mandej po krijohen edhe konflikte të reja, përkatësisht të “Stacioni i Autobusave”. Andaj apel për gjitha subjekteve politike ti shmangin tubimeve gjatë procesit mësimor, sepse po krijojnë shumë probleme!

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk ka pasur, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të kuvendit, në orën 12:20 h.

Video incizimi i këtij takimi të Kuvendit të Komunës së Pejës në kanalin zyrtarë në Youtube.

Kliko : <https://www.youtube.com/watch?v=78NwOXIFfiY>

Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina



KRYESUESI I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj

